



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:124314  
Datë: 20.03.2024  
Numri i dokumentit: 05476647

Ac.nr.7736/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Ardian Ajvazi dhe Kujtim Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L. B. nga fshati r.., Komuna e Lipjanit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sh.Sh.G., avokate me seli në rr. “..”, nr. .. në Fushë Kosovë, kundër të paditurës Komuna e Obiliqit, Drejtoria e Arsimit në Obiliq, me seli në rr. “Adem Jashari”, nr.2 në Obiliq, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson N.M. avokat në Prishtinë, për kompensim e pagave në emër të kualifikimit - licencimit, për ushqim gjatë punës dhe shpenzimet e udhëtimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3691/21, të datës 16.02.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 19.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Obiliqit, Drejtoria e Arsimit në Obiliq, me seli në Obiliq, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3691/21, të datës 16.02.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.3691/21, të datës 16.02.2023, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses L. B. nga fshati Ribar i Madh, Komuna e Lipjanit, ashtu që: DETYROHET e paditura Komuna e Obiliqit, Drejtoria e Arsimit në Obiliq, që paditëses në emër të kompensimit të diferencës se pagesës për kualifikim-licencim për periudhën kohore nga data 01.06.2018, deri me datë 17.06.2021, për 36 muaj t’ia paguajë shumën prej 1,994.40 euro, në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të punës për 417 ditë pune, për periudhën kohore nga data 01.06.2018, deri me datë 08.06.2021, t’ia paguajë shumën prej 834.00 Euro, si dhe në emër të shpenzimeve të

udhëtimit për periudhën nga data 01.06.2018, deri me datë 08.06.2021, t'ia paguajë shumën prej 934.08 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë datë 17.06.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi në dorëzim, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses L. B. nga fshati R. i M., Komuna e Lipjanit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Obiliqit, Drejtoria e Arsimit në Obiliq, që paditëses L. B., në emër të kompensimit të diferencës së pagesës për kualifikim-licencim për periudhën nga data 18.04.2017, deri me datë 01.06.2018, për 14 muaj t'ia paguajë shumën prej 775.60 euro, në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të punës për 120 ditë pune, për periudhën kohore nga data 18.04.2017, deri me datë 01.06.2018, t'ia paguajë shumën prej 240.00 Euro, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën nga data 18.04.2017, deri me datë 01.06.2018, t'ia paguajë shumën prej 268.80 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë datë 17.06.2021, e deri në pagesën definitive, SI E PA BAZUAR. III. DETYROHET e paditura Komuna e Obiliqit, Drejtoria e Arsimit në Obiliq, që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t'ia paguajë paditëses shumën prej 259.00 Euro, dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura përmes përfaqësuesit të saj, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit të Kosovës që ankesën e të njëjtës ta aprovojë si të bazuar.

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, ka paraqitur përgjigje në ankesë përmes së cilës i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të të paditurës më propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet në tërësi si i bazuar. Po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*Ankesa e të paditurës është e pabazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja L. B., përmes të autorizuarit të saj, me datë 17.06.2021, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, kundër të paditurës, të cilën e ka precizuar përmes parashtresës së datës 11.10.2022, për kompensimin e pagave mbi kualifikimin, shujtës ditore dhe shpenzimeve të udhëtimit, me pretendimet se e njëjta është e punësuar tek e paditura, përkatësisht në SHFMU "Dr. I. R." në Obiliq si mësimdhënëse dhe se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit, paditëses i takon kompensimi për pagat mbi kualifikimin, shujtës ditore dhe shpenzimeve të udhëtimit (më detajisht si në petitumin e padisë si në shkresa të lëndës). Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.3691/21, të datës 16.02.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se “në bazë të provave të administruara, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, ngase është vërtetuar fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, dhe e njëjti ka diplomuar në Fakulteti Filozofik Dega Histori, dhe mbi bazën e saj e ka fituar titullin Profesor i Historisë, dhe ka licencë të mësimdhënësit-Licencë të Karrierës, dhe që nga data 01.06.2018, deri me datë 08.06.2021, ka 417 ditë të prezencës në punë ditën prezent në punë dhe së e paditura nuk ia ka kompensuar paditësit shpenzimet e ushqimit për ditët e pranisë në punë në vlerë prej 2 euro në ditë, shpenzimet e udhëtimit në vlerën e 70% të biletave të trafikut urban, si dhe kompensimin për licencim në vlerën e 27%, të pagës bazë, edhe pse një obligim i tillë është paraparë me nenin 7 par.1, pika 1.1, nenit 35 par.5 dhe 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, 01B-Nr.prot.2056, të datës 18.04.2017 dhe të kontratës në vazhdim datë 22.01.2021.

Më tutje ka theksuar se gjykata vlerësoi pretendimet e të paditurës se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së paditëses mirëpo përmes padisë dhe kërkesëpadisë, paditësja ka kërkuar kompensimin e pagave në emër të kualifikimit – licencimit për periudhën kohore 18.04.2017 e deri me datën 17.06.2021, ndërsa kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit për periudhën kohore 18.04.2017 – 08.06.2021, ndërsa padinë e ka paraqitur me datë 17.06.2021. Në këtë kuptim, meqë kërkesa për kompensimet e tilla duhet të paraqitet brenda afatit prej 3 vitesh, nga kjo rrjedh se kemi të bëjmë me parashkrim të pjesshëm të kërkesës dhe atë për periudhën nga data 18.04.2017 e deri me datë 01.06.2018. Bazuar në faktin se gjatë periudhës së lartcekur vërtetohet se paditësja ka realizuar punë tek e paditura për gjithsej 14 muaj, Gjykata vlerëson se paditëses nuk i takon e drejta në kompensimin e pagave në emër të kualifikimit-licencimit për këto muaj dhe duke e shumëzuar këtë periudhë me shumën prej 55.40 Euro (14x55.40), rrjedh se duhet refuzuar kjo pjesë e kërkesëpadisë në shumën e përgjithshme prej 775.60 Euro. Po ashtu, meqenëse gjatë periudhës së lartcekur vërtetohet se paditësja ka qenë prezentë në vendin e punës për 120 ditë pune, Gjykata vlerëson se paditëses nuk i takon e drejta në kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për këto ditë të pranisë në punë dhe duke e shumëzuar këtë me shumën prej 2 Euro për ditë pune (120x2), rrjedh se duhet refuzuar kjo pjesë e kërkesëpadisë në shumë prej 240.00 Euro. Në anën tjetër, sa i përket shpenzimeve të udhëtimit, meqenëse është vërtetuar fakti se shpenzimet ditore për paditësen në të dy-drejtimit arrijnë shumën prej 3.20 Euro, ndërsa paditëses i takon 70% e biletës së udhëtimit, duke e shumëzuar këtë me 120 ditë pune aq sa paditësja i ka realizuar në periudhën 18.04.2017- 01.06.2018 (384.00x70%), rrjedh se duhet refuzuar kjo pjesë e kërkesëpadisë në shumë prej 268.80 Euro. Bazuar në këto arsye, u vendos si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 7, paragrafi 1, pika 1.3, nenit 35, paragrafi 5 dhe 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e lidhur me nenin 33, paragrafi 1, pika 1.1 të Udhëzimit Administrativ Nr.05/2017 Sistemi i Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë. Po ashtu i është

referuar dispozitave ligjore nga neni 245, paragrafi 1 dhe 341, paragrafi 3 të Ligjit për Marrëdhënien e Detyrimeve. Lidhur me kamatën ka vendosur konform nenit 382 të LMD-së derisa për shpenzimet e procedurës i është referuar dispozitave ligjore nga neni 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike ngase nuk është kontestues fakti se paditësja është e punësuar si mësimdhënëse pranë SHFMU “Dr. I. R.” në Obiliq, e që vërtetohet përmes Kontratës së Punës me nr. protokolli 170/2016, të datës 01.09.2016 dhe e njëjta është e pajisur me diplomë me nr.1060, të datës 22.05.2008, me titull profesor i historisë si dhe licencë të mësimdhënësit me nr. 100016574. Po ashtu edhe sipas listës së pagave, lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, me datë 01.05.2021 provohet fakti se paditësja kualifikimin e ka me fakultet për të cilën parashihet kompensim në shumë prej 58,32 € e nga të cilat prova rrjedh se edhe e drejta materiale është zbatuar me të drejtë nga gjykata e shkallës së parë kur e njëjta ka vendosur që konform nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila përcakton se *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë 1.1 Mësimdhënës me Shkollë Normale 10 % e pagës bazë, 1.2 Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë 1.3 Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë...Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçar, magistraturë/master dhe doktoraturë 35% e pagës bazë”*, dhe mbi bazën e kualifikimit sipas pikës 1.3 të këtij neni është paraparë e drejta e kompensimit ashtu që për mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27 % e pagës bazë, gjë që në rastin konkret paditëses për shkak të licencimit të saj me kualifikim fakultet, me nivel kualifikim profesor i historisë, me të drejtë gjykata e shkallës së parë konform kësaj dispozite i ka aprovuar shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Po ashtu, gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat materiale kur ka vendosur që pjesërisht paditëses t’ia njeh kompensimin lidhur me shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit e kjo për faktin se nuk ka qenë kontestuese se për periudhën kohore të specifikuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, paditësja ka qenë në vendin e punës nga data 01.06.2018 e deri më datë 08.06.2021 dhe ka gjithsej 417 ditë dhe kjo vërtetohet përmes Vërtetimit të lëshuar nga e paditura, përkatësisht nga SHFMU “Dr. I. R.”, me nr. protokolli 1449/02, të datës 10.06.2021 derisa pjesa tjetër e kërkesës për periudhën nga data 18.04.2017 e deri më datë 01.06.2018 me të drejtë është vlerësuar si e parashkruar. Edhe në raport me shpenzimet e udhëtimit, gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka konstatuar se paditësja udhëton nga destinacioni ku e ka vendbanimin në fshatin Ribar i Madh në Lipjan për në vendin e punës në Komunën e Obiliqit dhe krahas kërkesës së saj ka bashkangjitur kuponët fiskal me biletat e udhëtimit, lëshuar nga Lipjani SH.P.K, në vlerë prej 1,00 €, nga SH.P.K Kastrioti në Obiliq, në vlerë prej 0,60 €, nga N.T “Erona” në vlerë prej 1,00 € derisa nga certifikata e vendbanimit me nr. B 10328268, e datës 09.06.2021, vërtetohet se paditësja e ka vendbanimin në fshatin Ribar i Madh në Lipjan. Kjo për faktin se me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se: *“Të punësuarve, (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e*

*pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy €) Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim*". Lidhur me shumën e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitën e nenit 35, paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se: "...Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban", e cila Kontratë është lidhur dhe është nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë, si dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës, dhe Kulturës e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, ndërsa paditëset deri në momentin e plotësimit të kushtit i kanë përmbushur kriteret e përcaktuara me këtë kontratë lidhur me kompensimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe mbi këtë bazë kërkesëpadia e tyre është e bazuar dhe aktgjykimi i atakuar vërtetohet në tërësi

Njëherit gjykata i ka vlerësuar të papranueshme pretendimet ankimore të paditurës se e njëjta nuk është nënshkruese e kontratës kolektive, ngase i njëjti është paraparë me dispozitat e KKAK-së, nënshkruese e të cilës është edhe MASHT-i, andaj e paditura nuk lirohet nga obligimi për pagesën e shumave të gjykuara, sepse kontratat e nënshkruara në mes palëve kanë bazë ligjore në LMD-në, dispozitat përkatës të këtij ligji neni 7 që e rregullojnë materien e çështjes së kontratës, si dhe konform nenit 8 par.1 të LMD-së, ku shprehimisht thuhet "Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit". Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive".

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadi së paditëses, duke e detyruar të paditurën që paditëses t'i paguaj në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021 dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.7736/2023, më datë 19.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,  
Besnik Bislimaj